

DEKLARATAT E NDËRMJETME E ADMINISTRATORIT

"Banka Amerikane e Investimeve" Sh.a., NIPT J91725007P

PJESA 1 – Hyrje

DEKLARATA E EMETUESIT

Me siguri të plotë, deklarojmë se i gjithë informacioni dhe të dhënat e paraqitura në këtë Deklaratë të Ndërmjetme të Menaxhimit janë të sakta dhe korrekte dhe se nuk është hequr asnjë informacion apo e dhënë që do të cenonte saktësinë dhe plotësinë e informacionit

nënshkruar nga Z. Andi Ballta Drejtor i Përgjithshëm Ekzekutiv



PËRGJEGJËSIA PËR INFORMACIONIN QË PËRMBAN DEKLARATA

Emetuesi pranon përgjegjësinë për informacionet dhe të dhënat që përmban deklarata. Informacioni është në përputhje me faktet dhe nuk lë jashtë asnjë të dhënë që do të cenonte vlefshmërinë e tij.

Kur përdoren të dhëna nga burimet e palëve të treta, informacioni në fjalë riprodhohet saktësisht dhe emetuesi është në gjendje të sqarojë informacionin e publikuar nga kjo palë e tretë dhe se nuk është lënë jashtë asnjë fakt që do ta bënte të pasaktë apo çorientues informacionin e riprodhuar.

Autoriteti nuk e ka verifikuar saktësinë dhe korrektesën e informacionit që përmban kjo deklaratë.

PJESA 2 – Të dhënat kryesore të emetuesit

Të dhënat e emetuesit	"Banka Amerikane e Investimeve" Sh.a
Selia dhe forma juridike e emetuesit	Rruga e Kavajës, Ndërtesa 27, H.1, Njësia Bashkiake 10, Kodi postar 1001, Tiranë, Shqipëri, e regjistruar pranë Regjistrat Tregtar në përputhje me vendimin Nr. 20830, datë 12 Shkurt 1999 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.
Numri i Identitetit të Personit Juridik (NIPT)	NIPT J91725007P
Ligji në bazë të të cilit ushtron veprimtarinë emetuesi	Banka Amerikane e Investimeve Sh.a zotëron licencë bankare, në përputhje me Ligjin Nr.9662, Për bankat në Republikën e Shqipërisë", datë 18 dhjetor 2006, Rregulloren e miratuar nga Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë me Vendim Nr. 14, datë 11.03.2009, "Për licencimin dhe ushtrimin e veprimtarisë së bankave dhe degëve të bankave të huaja në Republikën e Shqipërisë", version i integruar", e ndryshuar si dhe me legjislacionin në fuqi në Republikës së Shqipërisë.

Vendi i themelimit të emetuesit	Tiranë, Shqipëri
---------------------------------	------------------

PJESA 3 – Ngjarje të rëndësishme

Periudha	Janar 2025- Dhjetor 2025
Ngjarjet e rëndësishme	Më 27 nëntor 2025, Banka Amerikane e Investimeve Sh.a. ("ABI Bank") dhe NOA Sh.a. u bashkuan ligjërisht përmes përthithjes së NOA Sh.a. nga ABI si entiteti mbijetues. Kushtet dhe termat e bashkimit u miratuan nga aksionarët më 25 nëntor 2025, në përputhje me miratimin paraprak rregullator të marrë më 5 nëntor 2025, sipas Vendimit nr. 61 të Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë, me njoftimin e marrë më 21 nëntor 2025 Sipas statutit të ri dhe miratimit të aksionarëve, kapitali i paguar u bashkua ndërmjet ABI dhe NOA, duke rritur vlerën nominale për aksion, ndërkohë që numri i aksioneve nuk ka ndryshuar. Më 31 dhjetor 2025, kapitali aksionar i regjistruar i ABI raportoi në Lekë shqiptarë (ose "LEK") 4,182,773 mijë (2024: LEK 3,450,935 mijë), i përbërë nga 84,769 aksione me një vlerë nominale prej LEK 49,343.2
Shpjegim	Bashkimi është kontabilizuar duke përdorur metodën e vlerës kontabël (pooling of interests) dhe është pasqyruar që nga 1 janari 2025, siç shpjegohet më tej në shënimet 4(d) dhe 6(ix). Për rrjedhojë, informacioni krahasues i pasqyrave financiare paraqitet për vitin financiar të mbyllur më 31 dhjetor 2024 vetëm për ABI, në përputhje me parimet ekzistuese të kontabilitetit.
Ndikimi mbi pozicionin financiar të emetuesit dhe shoqërive të kontrolluara prej tij gjatë periudhës	Parametrat e kapitalit mbajtën aktivitetin e biznesit gjatë vitit 2025, duke raportuar një rritje të kredive bruto prej +17% dhe të depozitave të klientëve prej +18% gjatë vitit. Banka raportoi një fitim neto prej 3.92 miliardë LEK (+22% krahasuar me vitin e mëparshëm individual), ndërsa pasuritë totale arritën në 160 miliardë LEK (+14% krahasuar me pasqyrën individuale të vitit 2024). Kontributi i NOA në totalin e aktiveve për vitin financiar 2025 arriti në 10 miliardë LEK, i alokuar kryesisht në portofolin e kredive.

PJESA 4 – Transaksionet me palë të lidhura, në përputhje me nenin 7, pika 6 të kësaj Rregulloreje

Periudha	Janar 2025- Dhjetor 2025
Transaksionet	Transaksionet me palë të lidhura janë paraqitur në pasqyrat financiare të audituara shënimi 36.
Shpjegimet	Nuk ka
Ndikimi mbi pozicionin financiar të emetuesit dhe	Nuk ka

shoqërive të kontrolluara prej tij gjatë periudhës	
--	--

PJESA 5 – Informacion i përgjithshëm

Emetuesi	"Banka Amerikane e Investimeve" Sh.a
Përshkrimi i pozicionit financiar dhe performancës së periudhës përkatëse	- Viti 2025 përfaqësoi një etapë të rëndësishme në zhvillimin strategjik të ABI Bank. Pas një periudhe rritjeje të fortë dhe konsolidimi në tregun bankar shqiptar, fokusi ynë gjatë këtij viti ishte forcimi i themeleve të institucionit, zgjerimi i rolit të Bankës në mbështetjen e ekonomisë shqiptare dhe rritja e efikasitetit operacional. - Në një mjedis ekonomik dinamik dhe konkurrues, ABI Bank ndoqi një qasje të balancuar ndaj rritjes, duke ruajtur disiplinën financiare dhe fokusin te cilësia e portofolit. Portofoli bruto i kredive tejkaloi nivelin e 700 milionë eurove, ndërsa gjatë vitit u disbursuan mbi 200 milionë euro kredi të reja për ekonominë shqiptare. Aktiviteti kreditues, veçanërisht në segmentin Korporatë, u orientua drejt sektorëve me potencial zhvillimi, si turizmi, ndërtimi, energjia dhe tregtia, duke reflektuar rolin e Bankës si partner financiar për projekte me ndikim të drejtpërdrejtë në zhvillimin ekonomik të vendit. Në të njëjtën kohë, cilësia e portofolit mbeti në nivele shumë të kënaqshme, me një tregues të kredive me probleme rreth 1%, duke konfirmuar qasjen e kujdesshme të Bankës në menaxhimin e rrezikut për të disatin vit radhazi. Një zhvillim thelbësor gjatë vitit 2025 ishte finalizimi i bashkimit të institucionit financiar NOA me ABI Bank. Ky hap përfaqëson një nga transformimet më të rëndësishme strategjike në historinë e Bankës dhe sjell një model të ri operimi në tregun financiar shqiptar. Përmes këtij bashkimi, ABI Bank ka ndërmarrë një hap të qartë strategjik për zgjerimin e pranisë së saj drejt segmenteve të mikrofinancës dhe biznesit të vogël, pa humbur fokusin te klientët korporativë dhe sektorët strategjikë të ekonomisë. Ky model i integruar krijon një platformë financiare ku stabiliteti dhe kapacitetet financiare të Bankës ndërthuren me afërsinë ndaj klientit që karakterizon mikrofinancën. Bashkimi me NOA zgjeron ndjeshëm shtrirjen gjeografike të ABI Bank, dyfishon rrjetin e degëve dhe krijon mundësi të reja për mbështetjen e sipërmarrjes së vogël, zhvillimin rajonal dhe përfshirjen financiare në Shqipëri. Në këtë mënyrë, Banka pozicionohet si një nga institucionet financiare kryesore në vend, duke mbuluar të gjithë spektrin e financimit - nga mikrofinanca dhe biznesi i vogël, deri te projektet e mëdha korporative dhe infrastrukture. - Në të njëjtën kohë, segmenti Retail vijoi të jetë një motor i rëndësishëm i rritjes së Bankës. Baza e klientëve u zgjerua ndjeshëm dhe depozitat e individëve u rritën me ritme të qëndrueshme, duke e çuar pjesën e tregut të depozitave për individë në rreth 6.5%. Kjo performancë reflekton besimin e palëkundur të klientëve ndaj ABI Bank dhe suksesin e strategjisë sonë në ofrimin e vazhdueshëm të

	produkteve konkurruese, si dhe në përmirësimin e përvojës së klientit. Një kontribut të rëndësishëm në rezultatin financiar dha edhe Departamenti i Thesarit, i cili menaxhoi me efikasitet portofolin e titujve të Bankës, përfshirë tituj të qeverisë shqiptare, si edhe tituj sovranë dhe korporativë ndërkombëtarë. Paralelisht, aktiviteti i këmbimeve valutore u zgjerua ndjeshëm, duke kontribuar në rritjen e të ardhurave dhe duke reflektuar sinergjinë e plotë midis këtij departamenti dhe segmenteve të biznesit. Transformimi digjital përbëri një tjetër shtyllë të rëndësishme të zhvillimit gjatë vitit 2025. ABI Bank ndërmori hapa domethënës drejt përfshirjes në sistemin europian të pagesave, përmes operimit në SEPA dhe implementimit të standardeve të reja ndërkombëtare të pagesave. Paralelisht, investimet në bankimin online dhe mobile, në modernizimin e sistemeve teknologjike dhe në sigurinë kibernetike kontribuan në përmirësimin e efikasitetit operacional dhe në ofrimin e shërbimeve më të shpejta, më të sigurta dhe më të aksesueshme për klientët tanë. • Integrimi i NOA dhe zgjerimi i aktivitetit të Bankës krijuan një organizatë më të madhe dhe më të qëndrueshme, me rreth 800 profesionistë të përkushtuar. Kapitali njerëzor mbetet një nga avantazhet tona më të rëndësishme konkurruese dhe investimi në talente, zhvillimi profesional dhe kultura organizative do të vijojë të jetë një prioritet strategjik për Bankën. ABI Bank luajti një rol aktiv në jetën sociale dhe kulturore të vendit. Përmes një sërë iniciativash në fushën e arsimit, kulturës, sportit, mjedisit dhe solidaritetit social, Banka kontribuoi në projekte me ndikim të qenësishëm në komunitet dhe në zhvillimin e shoqërisë shqiptare. Sa i takon së ardhmes, ne do të vazhdojmë të fokusohemi në konsolidimin e mëtejshëm të modelit tonë të ri strategjik. Integrimi i plotë operacional dhe teknologjik i NOA, zgjerimi i shërbimeve digjitale dhe mbështetja e sektorëve me potencial zhvillimi do të jenë në qendër të veprimtarisë sonë gjatë vitit në vijim. Synimi ynë është i qartë: të forcojmë një institucion financiar modern, gjithëpërfshirës dhe inovativ, që mbështet zhvillimin e ekonomisë shqiptare në çdo nivel. • Rritje e fortë. Vlerë e shtuar për klientët. Depozita Totale 1227 milion EUR, +19.8% krahasuar me vitin e kaluar. Portfoli Bruto i kredive 739 milion EUR +21.1% krahasuar me vitin e kaluar, Fitimi neto 40 milion EUR +25.8% krahasuar me vitin e kaluar. Disbursime të reja 230 milion EUR, 802 punonjes dhe 59 njesi shërbimi. Kapitali i Bankës arriti vlerën prej 166 milionë Euro, duke u rritur me 30% në krahasim me 2024. • Falënderojmë klientët, partnerët dhe punonjësit tanë për besimin dhe përkushtimin e tyre, që mbeten themeli i çdo arritjeje të ABI Bank.
Shoqëritë e kontrolluara, nëse ka	ABI Broker sh.a

Përshkrimi i pozicionit financiar dhe performancës gjatë periudhës përkatëse	- Kompania bije te cilen e zoteron 100% ka nje total aktivesh 20,304,655 LEK, ku zerat kryesore jane, gjendja e parave ne banke 16,791,969 LEK dhe llogari te arketueshme 2,504,986 LEK. - Pasivet financiare me vlere 1,161,520 LEK. - Kapitali neto i shoqerise ishte 19,143,135 LEK. - Per periudhen e raportimit fitimi eshte 15,227,649 LEK
Shoqëritë e kontrolluara, nëse ka	ABI Invest sh.a
Përshkrimi i pozicionit financiar dhe performancës gjatë periudhës përkatëse	- Kompania bije te cilen e zoteron 100% ka nje total aktivesh 30,208,564 LEK, ku zerat kryesore jane, investimet Financiare VDATGJ 20,038,904 LEK. - Pasivet financiare me vlere 778,077 LEK. - Kapitali neto i shoqerise ishte 29,430,487LEK. - Per periudhen e raportimit fitimi eshte 2,663,491 LEK
Shoqëritë e kontrolluara, nëse ka	I.F.J.B NOA sh.a Prishtine, Kosove
Përshkrimi i pozicionit financiar dhe performancës gjatë periudhës përkatëse	- Kompania bije te cilen e zoteron 60 % ka nje total aktivesh 5,780,189 EUR, ku zerat kryesore jane, portofoli i kredise 4,348,994 EUR, gjendja e parave ne banke 962,184 EUR dhe 212,450 EUR ne aktive te patrupezuara. - Pasivet financiare me vlere 5,474,383 EUR , jane financimet nga ABI Bank ne Shqiperi, bankat ne Kosove dhe Shqiperi. - Kapitali neto i shoqerise ishte 305,806 EUR. - Humbja e vitit eshte 219,446 EUR.